

**PROJEKT ZBATIMI PËR "FURNIZIMI ME UJË I FSHATRAVE
GORICAJ, SOPEZ, SENESA, FERRAS, MËRTISH, KËMISHTAJ,
SPOLAT, GRADISHTË, FIER SEMAN, GUNGAS, BABUNJË,
BABUNJË E RE NË NJËSINË GRADISHTË**

Raportin teknik i projektit të propozuar për VNM




Prill 2024

KONSULENTI:



Porositësi:	Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër
Konsulentit:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Titulli i Projektit:	Projekt Zbatimi për "Furnizimi me Ujë i Fshatrave Goricaj, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolat, Gradishtë, Fier Seman, Gungas, Babunjë, Babunjë e re në Njësinë Gradishtë
Titulli i Dokumentit:	Raportin teknik i projektit të propozuar për VNM
Faza e Projektit:	Projekt Zbatimi
Kodi i dokumentit:	ICE-350-P03-V01 02

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
02	Për Zbatim		Prill 2024

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Manushaqe Jaçe 	Aurora Cërri			
Data:	Prill 2024	Prill 2024	Prill 2024		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2024

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	i
Lista e Tabelave	iii
Lista e Figurave	iv
1 Parathenie	1
2 Qëllimin e projektit të propozuar	2
3 PLANIMETRINË E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT, KU TË PASQYROHEN NË HARTË TOPOGRAFIKE KUFIJTË E SIPËRFAQES, TË SHOQËRUAR ME KOORDINATAT, SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGE, FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR PËRDORIMIN EKZISTUES TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORET PËRKOHËSISHT APO PËRHERË NGA PROJEKTI, GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT APO FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARISË.....	4
4 INFORMACION PËR QENDRAT E BANUARA, NË ZONËN KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR ME FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR DISTANCËN E TYRE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT TË PROPOZUAR, SI DHE PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE QË ADMINISTRON TERRITORIN KU PROPOZOHET PROJEKTI.....	5
4.1 Vendndodhja	5
4.2 Relievi.....	5
4.3 Hidrografia	6
4.4 Rrjeti rrugor	6
4.5 Furnizimi me energji elektrike	6
4.6 Furnizimi me uje	6
5 SKICAT DHE PLANIMETRITË E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIT, SI DHE MËNYRAT DHE METODAT QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIT.	9
5.1 Menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit.	10
6 PËRSHKRIM E PROCESVEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE /PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT.	11
7 INFORMACIONIN PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME PËR LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJË, SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA DHE MBETJEVE, SI DHE INFORMACIONIN PËR RRUGËT EKZISTUESE TË AKSESIT APO NEVOJËN PËR HAPJE TË RRUGËVE TË REJA.....	12
8 PROGRAMI PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN ENDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE, SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT.....	13
9 LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË TYRE (MATERIALE NDËRTIMI, UJË DHE ENERGJI)	14
10 INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH/PRANË ZONËS SË PROJEKTIT.	15
11 TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.	16
12 AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, SI NDËRTIMI I KAMPEVE APO REZIDENCEVE ETJ.....	17

13	Informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bera në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.....	18
14	INFORMACION PËR ALTERNATIVAT E MARRA NË KONSIDERATË, PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORËT.	19
15	Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bera në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.....	20
15.1.1	Depo Gradishtë.....	20
15.1.2	Skica dhe detaje të objektit.....	22
15.2	Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike.....	24
15.2.1	Procese dhe të dhëna.....	24
15.2.2	Parametrat dhe supozimet e projektimit.....	24
15.3	Informacionin për infrastrukturën e nevojshme.....	26
15.3.1	Rrjeti Elektrik, Sistemi i Ndriçimit dhe IT	26
15.3.2	Sistemi i furnizimit me ujë (FUP).....	27
15.3.3	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN)	28
15.3.4	Sistemi i largimit të ujërave të shiut (KUSH).....	28
15.4	Programin për ndërtimin, "Grafiku i punimeve"	29
15.5	Materiale ndërtimi	29
15.6	Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera	29
15.7	Informacionin për alternativat e marra në konsideratë	30
15.8	Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para	31
15.9	Aktivitete të tjera që mund të nevojiten	31
15.10	Informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat për projektin	31
15.11	Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi.....	31
16	Korespondenca	32
17	Kriteret e projektimit	34
17.1	Kodet, standardet dhe dokumentet teknike.....	34
	Referencat	35

LISTA E TABELAVE

Tabela 4-1: Tabela e lidhjeve të mundshme sipas detyres projektimit.....	5
Tabela 4-2: Puset e kryera në këtë zonë dhe parametrat e tyre sasiorë dhe cilësor.....	7
Tabela 15-1: Parametrat dhe supozimet e projektimit për sistemin e furnizimit me uje	25
Tabela 16-1: Lista e kërkesave për institucionet	32
Tabela 16-2: Lista e kthim përgjigjeve në pritje	33

LISTA E FIGURAVE

Figura 3-1: Planimetria e përgjithshme e ujësjetës të fshatrave të njësise administrative Gradishtë	4
Figura 4-1: Foto nga zona e projektit të propozuar	8
Figura 8-1: Grafiku i punimeve	13
Figura 15-1: Prerje e depos	20
Figura 15-2: Plani i themelit të depos	21
Figura 15-3: Planimetria e depos	21
Figura 15-4: Planimetria e ujësjetës	22
Figura 15-5: Tërthori tip i kanaleve	23
Figura 15-6: Puseta e shkarkuesit	23
Figura 15-7: Pamje nga burimi VM 4	28
Figura 15-8: Grafiku i punimeve	29
Figura 15-9: Horografia	30

1 PARATHENIE

Hartimi i raportit teknik të projektit të propozuar është kryer në bazë të **VKM nr. 686, datë 29.07.2015** "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore" dhe **Vendimit nr. 95, datë 14.02.2018** "Për disa shtesa dhe ndryshime tek **VKM nr. 686, datë 29.07.2015**"

2 QËLLIMIN E PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Projekti "Studim Projektim për Furnizimi me ujë i Fshatrave Goriçaj, Sopëz, Senesa, Ferras, Mertish, Këmishtaj, Spolat, Gradishte, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e Re" përfshin një list objektesh të shpërndara në një hapësirë të konsiderueshme duke përfshirë disa fshatra të Njesise Administrative Gradishte.

(a) Qëllimin e projektit të propozuar;

Projekti synon sigurimin e furnizimit me ujë të sigurt, higjenikisht të pastër me mbulimin e kostos dhe tarifave të pranueshme socialisht për zonat e përzgjedhura në zonën e studimit.

Ky furnizim përfshin: stacionet e pompimit, linjën e transmetimit, rrjetin e shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive për zonat e përzgjedhura.

Rezultatet e pritura të këtij projekti mund të përmblihen si më poshtë:

- Lidhja 100 % e popullsisë së fshatit me ujë të pijshëm të sigurt.
- Furnizimi me ujë të pijshëm të sigurt sipas standardeve, parashikuar për 25 vite.
- Furnizimi i klientëve me ujë me presion të mjaftueshëm (min 1.5 bar në dalje në çezmën e konsumatorit dhe max 6.0bar) me ujë me cilësi sipas Standardeve Shqiptare dhe udhëzimeve të EU.
- Skemat e furnizimit me ujë në fshatrat e synuara funksionojnë dhe mirëmbahen siç duhet.
- Investimet e nevojshme në fshatrat e projektit për arritjen e objektivave të projektit janë identifikuar gjatë fazës së mëparshme të fizibilitetit.

(b) Gjendja ekzistuese;

Aktualisht në fshatrat e njësisë administrative Gradishte mungon sistemi i furnizimit me ujë. Banorët e këtyre fshatrave furnizohen me puse vetjake pa asnjë kontroll të cilësisë dhe higjenës së tyre ose duke e blerë ujin e pijshëm.

Për realizimin e projektit po rishikohet i gjithë informacioni ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartohet për furnizimin me ujë sipas detyrës së projektimit.

Për realizimin e projektit, projektuesit i kërkohet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë për furnizimin me ujë sipas kësaj detyre të projektimit.

Projekti synon sigurimin e furnizimit me ujë të sigurt, higjenikisht të pastër me mbulimin e kostos dhe tarifave të pranueshme socialisht për zonat e përzgjedhura në zonën e studimit.

2.2.1.1 Detyrat Kryesore që do të Zgjidhe Projekti

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

- hapjen e një pusi të ri e cila do të ndihmojë në furnizimin e ujë,
- ndertimi i një depoje të re në Gradishte,
- linja e dergimit nga pusi i ri deri në depon e re,
- linja e dergimit e cila lidhet në depon ekzistuese të Grabianit dhe percjell ujë për në depon e re Gradishte,
- rrjetin e shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive për zonat e përzgjedhura.

2.2.1.2 Rezultatet e pritura të këtij projekti mund të përmblihen si më poshtë:

- Lidhja e 100% e popullsisë në fshatrat e projektit me ujin e pijshëm të sigurt.



- Furnizim me ujë të pijshëm të sigurt sipas standardeve të BE-së
- Skemat e furnizimit me ujë të operohen dhe mirëmbahen siç duhet.

3 PLANIMETRINË E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT, KU TË PASQYROHEN NË HARTË TOPOGRAFIKE KUFIJTË E SIPËRFAQES, TË SHOQËRUAR ME KOORDINATAT, SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGE, FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR PËRDORIMIN EKZISTUES TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORËT PËRKOHËSISHT APO PËRHERË NGA PROJEKTI, GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT APO FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARISË.

Planimetria e vendosjes së projektit




Figura 3-1: Planimetria e pergjithshme e ujesjellesit te fshatrave te njesise administrative Gradishtë

4 INFORMACION PËR QENDRAT E BANUARA, NË ZONËN KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR ME FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR DISTANCËN E TYRE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT TË PROPOZUAR, SI DHE PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE QË ADMINISTRON TERRITORIN KU PROPOZOHET PROJEKTI.

Zona ku do te zbatohet projekti "Studim Projektim për Furnizimi me ujë i Fshatrave Gorica, Sopëz, Senesa, Ferras, Mertish, Këmishtaj, Spolat, Gradishte, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e Re" i perket njesise administrative Gradishte. Njesia administrative ka nje popullsi prej 10'236 banoresh.

Referuar te dhenave nga detyra e projektimit jepet me poshte numri i lidhjeve te mundshme.

Tabela 4-1: Tabela e lidhjeve te mundshme sipas detyres projektimit

Nr.	Fshati	Nr i shtepive	Nr.	Fshati	Nr i shtepive
1	Gorica	198	11	Këmishtaj 4	20
2	Sopez	163	12	Spolat	213
3	Senesa	35	13	Gradishte	171
4	Ferras	133	14	Fier seman 3	24
5	Mërtish1	52	15	Fier seman 2	99
6	Mërtish2	52	16	Fier Seman 1	63
7	Mërtish (koria)	41	17	Gungas	112
8	Këmishtaj 1	70	18	Babunje	100
9	Këmishtaj 2	34	19	Babunje 2	39
10	Këmishtaj 3	25	20	Babunje e re	76
		917			803

4.1 Vendndodhja

Zona ku do te zbatohet projekti eshte pjese e Bashkise Divjake. Bashkia Divjake kufizohet ne veri me bashkine Rrogozhine, ne lindje me bashkine Lushnje, ne jug me bashkine Fier dhe ne perendim me Detin Adriatik.

Zona e Gradishtes ka aktivitet kryesor ekonomik bujqesine. Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.

4.2 Relievi

Zona në studim përfaqësohet me një terren fushor dhe kodrinor.

Zona fushore shtrihet në jug dhe lindje dhe fillon në Fier-Seman dhe në lidje duke u zgjatur drejt jugut dhe përfaqëson Fushën e Tërbufit. Kuota në qënder varion nga 2.5 m në 4 m.

Në perendim kuotat kanë rritje të vogël deri sa pranë vijës ngritëse me kodrat ato arrijnë deri 4.5 m.

Pjesa kodrinore e zonës në studim në përgjithësi ka ngritje graduale deri pranë nivelit të fshatrave, kurse më sipër drejt perëndimit, pjerrësia bëhet më e theksuar, e veshur me shkurre dhe lis.

Kjo zonë ka zgjatim veri-jug që nga veriu Gërmenjit të Madh me kuotë 104 m mbi nivel të detit 116.8 m, sipër në perëndim të Grabianit, në veri të Gradisht në kodra me lartësi 97-129 m.

Lartësia më e madhe mbi nivel të detit takohet në perëndim të fshatit Spolat 172.7 m. Gjatë zgjatimit të këtij vargu kodrash shpesh krijon shumë lugina të ndara, ngritje të vogla të shkëputura me lartësi të ndryshme, etj.

4.3 Hidrografia

Në zonën tonë në studim rrjeti hidrografik është shumë pak i dukshëm.

Me përjashtim të disa prroskave, apo të një përroi të vogël që rrjedh gjatë shirave në Grabian nuk ka rrjedhje të tjera.

Nga ana hidrografike kemi edhe disa rezervuar, të cilët ndodhen në veri të Gradishtit dhe jug të Grabianit rreth 1 km dhe përfaqësohet nga rezervuari i Përroit të Plemes me një sipërfaqe rreth 1500-2000 m². Rezervuari i cili ndodhet në perëndim të fshatit, në krye të tij i cili ka një sipërfaqe të vogël, si dhe rezervuari i cili ndodhet në veri-perëndim të fshatit Grabjan. Këto rezervuar ujëmbledhës shërbejnë për vaditjen e tokave të zonës.

4.4 Rrjeti rrugor

Te gjithë fshatrat e njesise lidhen me qendren e njesise me rruge automobilistike te asfaltuara. Disa segmente rruges ne brendesi te fshatrave jane te pashtuara dhe mungon sistemi i ndricimit.

4.5 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike do të realizohet nëpërmjet rrejtit 3-fazor me tension 400 V dhe frekuencë 50 Hz. Linja elektrike furnizuese do të shërbejë si hyrje në kuadrin elektrik, i cili është me mbrojtje mekanike, hidrike dhe grimcave të pluhurit me IP të treguar në fletët e vizatimit përkatës. Kuadri elektrik do të përmbajë mbrotjen magneto-termike kryesore dhe diferenciale; gjithashtu, secila linjë kryesore sistemi është mbrojtur me mbrotje magneto-termike

4.6 Furnizimi me uje

Nuk ka te dhena per rrjetin ekzistues te fshatrave te njesise Gradishte. Fshatrat e zones se projektit furnizohen nga puse vetjake pa asnje kontroll.

Ujësjellës-Kanalizime sh.a Lushnje, kërkon përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm të fshatit Gradisht, Mëhallas, Spolat dhe zonës përreth me një sasi uji me prurje $Q = 10$ l/s. Nisur nga kjo kërkesë, kushteve hidrogeologjike të zonës dhe mirë funksionimi i ujësjellësit u pa si më e arsyeshme sigurimi i një sasive uji prej 3-5 l/s nga kryerja e një pus-shpimit në zonën e Gradishtës dhe plotësimi i sasisë tjetër të ujit nga ujësjellësi i Grabianit.

Sot nga stacioni i Gradishtës (pusi ekzistues) sigurohet një sasi uji me prurje $Q = 2$ l/s.

Në zonën e studimit janë kryer disa pus-shpime, me karakter kërkim shfrytëzim të ujërave nëntokësore në suitën Rrogozhina që nga vitet 1988 e deri më sot në disa raste edhe dublime të tyre.


Tabela 4-2: Puset e kryera në këtë zonë dhe parametrat e tyre sasiorë dhe cilësorë


Nr. Shpimit	X	Y	Thellësia (m)	Prurja Q (l/s)	Prurja specifike (l/s/m)	Fp ° gjermane	NH4 (mg/l)
Gradisht (stacioni)	4381101	4529406	100	2		27.65	0
3/88 Spolat	4380252	4532826	192	0.15	0.06	23	
1/88 Gradisht	4380920	4529178	252	0.05	0.07	40	
2/88 Gradisht	4381079	4533971	225	5	0.94	21.48	
Pusi Nr.1 Grabjan	4381188	4534632	180	8.0-10.0	0.5	27.3	0.25
Pusi Nr.2 Grabjan	4381192	4534941	180	8.0-10.0	0.5	29.05	0.2
Pusi Nr.3 Grabjan	4381312	4535179	180	8.0-10.0	0.5	22	0.18
Pusi Nr.4 Grabjan	4381143	4535108	180	8.0-10.0	0.5	16.45	0.5



Figura 4-1: Foto nga zona e projektit te propozuar

5 SKICAT DHE PLANIMETRITË E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIT, SI DHE MËNYRAT DHE METODAT QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIT.





5.1 Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit.

5.1.1.1 Pastrimi dhe pergatitia e sheshit.

Traseja neper te cilen do te shtrihen linjat e tubacioneve ka shume pak, ose aspak vegjetacion te ulet. Asnje dru nuk do te pritet qe eshte jashte trasese se ndertimit te veprave te ujesjellesit te propozuar.

Te gjitha paisjet qe do te kerkohen te perdoren dhe sjellin zhurma me te medha duhet te kufizohen ne oret e funksionimit, sipas situates perreth. Ne ditet qe ato do te perdoren do te synohet te kete nje numer minimal te punonjesve ne trasene e kanaleve dhe te tubacioneve.

5.1.1.2 Konflikti me perdorimin aktual te tokes si toke bujqesore

Nuk do te merret toke me qira per trasene e kanaleve dhe te tubacioneve, meqenese punimet do te jene kryesisht pergjate rrugeve ekzistuese.

5.1.1.3 Shqetesime te ndryshme qe mund ti shkaktohen komuniteteve lokale

Te gjitha lejet duhet te merren nga autoritetet e komunitetit dhe nese perkohesisht preken siperfaqe toke, ato pas perfundimit te punimeve duhet te kthehen ne gjendjen fillestare.

5.1.1.4 Vendosja e veprave te ujesjellesit

Nderhyrjet ne toke, gjate hapjes se kanaleve te tubacioneve pritet te sjellin shqetesime te ndryshme.

Gjeresia e trasese se kanaleve qe do te hapet te jete minimale per te zvogluar demtimin e siperfaqes se tokes dhe te sasise se dherave te germuara.

5.1.1.5 Magazinimi dhe trajtimi i materialeve te rrezikshme

Duhet treguar kujdes per te evituar ndotjen e tokes dhe ujit nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme te lubrifikanteve dhe solventeve qe do te perdoren gjate ndertimit te veprave. Nje plan emergjence duhet te pregatitet ne rast te rrjedhjeve te lubrifikanteve dhe solventeve.

5.1.1.6 Hedhja e mbeturinave te ngurta dhe te lenget

Problemet shqetesuese qe lidhen me ndotjen e mjedisit jane dhe mbetjet e ngurta qe do te gjenerohen gjate ndertimit te ujesjellesit. Keto mbetje do te duhet te hidhen ne vende te caktuara nga pushteti lokal.

6 PËRSHKRIM E PROCESVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE /PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT.

Punimet qe do te kryhen ne kete projekt

- hapjen e një pusi të ri e cila do të ndihmojë në furnizimin e ujë,
- ndertimi i një depoje të re në Gradishte,
- linja e dergimit nga pusi i ri deri në depon e re,
- linja e dergimit e cila lidhet në depon ekzistuese të Grabianit dhe percjell ujë për në depon e re Gradishte,
- rrjetin e shperndarjes dhe lidhjet e shtepive për zonat e përzgjedhura.

7 INFORMACIONIN PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME PËR LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJË, SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA DHE MBETJEVE, SI DHE INFORMACIONIN PËR RRUGËT EKZISTUESE TË AKSESIT APO NEVOJËN PËR HAPJE TË RRUGËVE TË REJA.

Rruget

Përafrimi i rrjetit të ardhshëm të ujit dhe shumica e rrjetit kryesor të transmisionit ndjek rrugët ekzistuese dhe rrugë të pashtuara. Disa nga kanalet e rrugës ku do të vendoset linja e transmetimit karakterizohen nga specie bimore të zakonshme. Disa nga kanalet përdoren për kullimin e ujërave të zeza shtëpiake. Rrjeti i transmetimit dhe rezervuarët tregojnë tashmë ndikimin njerëzor. Prerjet e bimeve dhe shkurreve nuk mund të përjashtohen veçanërisht në pjesën e parë të rrjetit të dergimit.

Kantieri i ndertimit të kontraktuesit duhet të vendoset në një zonë tashmë të ndikuar nga njeriu me parking, rrugë, oborr. Prerja e pemëve dhe shkurreve duhet të shmanget gjatë vendosjes së kantjerit. Flora dhe fauna nuk do të preken gjatë transportit të materialeve ndertimore për të depozituar dhe vendin e hapjes së pusit të ri.

Nga projekti nuk janë parashikuar ndertimi i rrugëve ndihmese pasi nuk është e nevojshme pasi veprat aksesohen nga rruget ekzistuese të zonës.

Shkarkimi i mbetjeve

Gjate kryerjes së operacioneve të ndertimit do të ketë krijim të mbetjeve inerte (dhera, masa të vogla shkembore) si rezultat i punimeve të ndryshme. Keto klasifikohen si mbetje ndertimore nëse lind nevoja e depozitimit apo zhvendosje nga zona në një sipërfaqe tjetër. Shoqëria që do të zbatojë projektin duhet të planifikojë qarte mënyrën e administrimit të inerteve për të menjuar mundësinë e depozitimit të tyre në vende të papershtatshme. Një pjesë do të përdoret për mbushjen dhe rehabilitimin e zonave ku janë kryer germime, pjesa që mbetet do të depozitohet në vende të caktuara për të cilin investitori do të bjere dakort me organet e pushtetit vendor. Kompania do të marrë të gjitha masat për depozitimin e tyre në vende të posacme, të cilat në përfundim do të rehabilitohen nga pikepamja mjedisore së bashku me sipërfaqet e tjera që do të mbushen.

Gjate aktivitetit duhet të mbahen parasysh kërkesat e Ligjit nr.156 datë 10.10 2013, Për disa ndryshime në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

Me shumë nevojë për rehabilitim do të ketë rikthimi i rrugëve në gjendjen e mëparshme pasi aty do të bëhet pjesa më e madhe e germimeve si pasoje e ndertimit të rrjetit të ri të shpërndarjes, ndertimit të pusëve, ndertimit të lidhjeve me pallatet dhe shtëpitë etj.

Nga volume që do të dalin nga germimet, pjesa më e madhe e tyre do të përdoret për mbushje ndërsa një përqindje e vogël do të shpërndahet në sipërfaqe depozitimi të caktuara.

Pjesa e dherave që do të shpërndahet në sipërfaqe depozitimi do të ngjeshet dhe do të mbillet me shkurre dhe bimesa vendase në mënyrë që fenomeni erodues nga shirat dhe ujërat të parandalohet, po ashtu bimesia që duhet të mbillet duhet të jetë autoktone për të mos thyer pejsazhin karakteristik të zonës. Keto punime do kryhen në mbyllje të çdo procesi operacional sipas planit të punimeve respektive.

Furnizimi me ujë.

Furnizimi me ujë gjatë fazës së punimeve do të bëhet me autobote të medha aty ku nevojitet.

9 LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË TYRE (MATERIALE NDËRTIMI, UJË DHE ENERGJI)

Lendet e para që do përdoren për zbatimin e projektit të propozuar:

- Çakull ose zhavorr lumi
- Rere
- Hekur
- Uje

Material rrethor që shërben për mbushje dhe sistemimin e shesheve dhe kanaleve të hapura.

Sigurimi i materialeve realizohet me transport për në objekte.

10 INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH/PRANË ZONËS SË PROJEKTIT.

Ky projekt mendohet të ketë lidhje me projekte të tjera që janë planifikuar të zbatohen në këtë zonë.
Rrjeti i ujësjetës të ri do të lidhet me Remasin.

11 TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.

Gjate funksionimit do te kemi konsum te :

- Energjise elektrike
- Tubacioneve
- Pajisjeve
- Kosto per Mirembajtje

12 AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, SI NDËRTIMI I KAMPEVE APO REZIDENCAVE ETJ.

Per zbatimin e projektit do ndertohen kampe me kontejner qe do jene kontejner shërbyes për objekte ndërtimore.

13 INFORMACIONIN PER LEJET, AUTORIZIMET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PER PROJEKTIN, NE PERPTHJE ME PERCAKTIMET E BERA NE LEGJSLACIONIN NE FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PER LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENCIMIN E PROJEKTIT.

- Miratimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Leje nga Ministria Infrastruktures dhe Energjise etj.

14 INFORMACION PËR ALTERNATIVAT E MARRA NË KONSIDERATË, PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORET.

Perzgjedhja e vendodhjes së projektit është ndikuar nga nevoja e rehabilitimit të fshatrave të njesise administrative Gradishte.

15 KOPJE TE LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENCAVE QE DISPONON ZHVILLUESI PER PROJEKTIN E PROPOZUAR, NE PERPUTHJE ME PERCAKTIMET E BERA NE LEGJISLACIONIN NE FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PER LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENCIMIN E PROJEKTIT.

Ujesjelles Kanalizime Lushnje sha. eshte ne proces aplikimesh per lejet dhe autorizimet ne institucionet perkatese dhe eshte ne pritje te ketyre miratimeve per projektin e propozuar "Studim Projektim për Furnizimi me ujë i Fshatrave Goriçaj, Sopëz, Senesa, Ferras, Mertish, Këmishtaj, Spolat, Gradishte, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e Re në njësinë Gradishtë".

15.1.1 Depo Gradishtë

Fshati Gradishtë aktualisht furnizohet me ujë nga depo me $V=1500m^3$ ne kuotën 112 m.m.n.d.

Rezervuari I ri do te ndërtohet ne pjesën e sipërme te fshatit ne lartësinë 120m.m.n.d. Vëllimi I depos është llogaritur 1500m³ duke marre parasysh dhe mundësinë për furnizimin me ujë te fshatit Remas dhe lidhje me rrjetin e qytetit nga kjo depo.




Figura 15-1: Prerje e depos




Figura 15-2: Plani i themelit të depos





Figura 15-3: Planimetria e depos

15.1.2 Skica dhe detaje te objektit



Figura 15-4: Planimetria e ujesjellësit



Tipi 2.2: Tërthor tip i kanalit të tubave të dergimit dhe tubave kryesorë
Sh.1:20





Figura 15-5: Tërthori tip i kanaleve



Lista e Përbërësve						
Poste	Përshkrimi	Diametri (mm)	Gjatësia (mm)	Presioni max (bar)	Njësia	Sasia
1	Tub ose Filtër për instalimin në mur	var.	var.	16	copë	1
2	Filtër Adapter	var.	-	16	copë	1
3	Flap Valve	var.	-	16	copë	1

Figura 15-6: Puseta e shkarkuesit

Për me shume informacion plotësues rreth projektit:

- Referohu vizatimeve të projektit në fletët B1, B2 B3, B4, B5, C1, D1, D2 etj. për skicat, planimetritë dhe detaje rreth projektit.
- Metodat e përzgjedhura për ndërtim janë dhënë në varësi të normave në fuqi, si dhe një pjesë e mirë e tyre përshkruhen në specifikimet teknike të projektit **“ICE-350-P03-V01 01 Specifikimet teknike - Ujësjellësi Gradishte”** Megjithëse për detajet e zhvillimit të mëtejshëm rreth zbatimit të projektit do të paraqiten në faza të tjera, të cilat ndërtuesi (kontraktori) i punimeve do të paraqesë metodologjitë e tij të punimeve për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

15.2 Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike

(d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

Ne proceset ndërtimore mund të përmendim, Punime gërmimi, Veprat e artit dhe struktura; Rrjeti inxhinierik elektrik dhe ndriçimi, sistemi i Kullimit të Ujërave të Shiut, etj.

15.2.1 Procese dhe të dhëna

a) Punime prishje, pastrimi dhe hapje të sheshit të ndërtimit;

Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia
Punime prishjeje dhe pastrimi	m ²	1200

b) Punime dherash;

Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia
Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m ³	1200
Gërmim dheu me ekskavator goma, 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m ³	2426
Gërmim me krahe ne seksion te detyruar me gjerësi b > 1 m, h=1.5 m, toke e forte.	m ³	628
Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III	m ³	2785
Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir	m ³	1456
Gërmim shkëmb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir	m ³	970

c) Punime shtresash, asfaltimi, trotuari, kanale dhe sinjalistika;

Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia
Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m ²	1529
Skarifim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m ²	1038
Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m ²	2309

15.2.2 Parametrat dhe supozimet e projektimit

Përqindja e kostove për ndërtimin e masave për shuarjen e zjarrit për vendbanimet e vogla mund të arrijë në më shumë se 30% të koston totale të ndërtimit. Prandaj, sasia e ujit që kërkohet për shuarjen e zjarrit për vendbanimet më të vogla duhet të kufizohet për të shmangur një mbi permasim të rezervuarëve dhe rrjetit të shpërndarjes.

Për këtë arsye, rezervuarët janë projektuar për një volum të luhatshëm në ditën e pikut të kërkesës mesatare ditore bazuar në kërkesën mesatare specifike prej 200 l/b/d. Duke pasur parasysh se kërkesa specifike mesatare për projektimin e sistemit të furnizimit me ujë varion ndërmjet 150 - 200 l/b/d, konsiderohet se vëllimi i depozitimit të rezervuarit përfshin një rezervë për shuarjen e zjarrit. Linjat e shpërndarjes janë projektuar për kërkesën maksimale për orë të ujit pa sasi për shuarjen e zjarrit për të shmangur mbipërmasimin e rrjetit. Megjithatë, hidranti do të vendoset përgjatë seksionit të tubit prej OD 90 mm.

Sipas informacioneve në terren, në fshat nuk ka stacion zjarrfikës. Shuarja e zjarrit është siguruar me autocisternë të zjarrfikësve të Divjakes.

Tabela 15-1: Paramentrat dhe supozimet e projektimit për sistemin e furnizimit me ujë

Nr.	Pershkrimi	Vlerat	Comment
1	Linjat e jashtme		
1.1	Shpejtesia	1.5 – 2 m/s	
1.2	Koeficienti i vrazhdësisë për llogaritjen hidraulike	k = 0.1 mm	
1.3	Valvul e çlirimit të ajrit	Valvulat e çlirimit të ajrit vendosen në tubacione, ku presioni i funksionimit pritet të jetë më i ulët se ai që mbizotëron në seksionet fqinje të tubacionit, d.m.th. a) në çdo pikë të lartë maksimale, b) në çdo pikë të lartë të përkohshme, c) në seksione të gjata në rritje ose në rënie të tubit në një distance prej 800 m,	Referuar profilave gjatësor
1.4	Pusetat e shpëlarjes	Në pikat e ulëta sipas profilit gjatësor	Referuar profilave gjatësor
2	Rrjeti shpërndarës		
2.1	Prurja e projektimit	Rrjedha maksimale për orë	
2.2	Shpejtesia	Rrjeti kryesor i shpërndarjes: 1 – 2 m/s, Rrjeti sekondar: 0,5 – 0,8 m/s	
2.3	Presioni në rrjet	presioni minimal: 2 bar mbi konsumatorin më të lartë, presioni hidrostatik në qendër të zonës së presionit: 5 bar, presioni hidrostatik maksimal: 6.5 bar	
2.4	Presioni maksimal i projektimit	PN 10	
2.5	Presioni i shërbimit (në ngritje të lidhjes së shtëpisë)	Presioni i furnizimit: 2 bar mbi konsumatorin më të lartë, valvula e reduktimit të presionit nëse presioni në konsumator është më i lartë se 6.5 bar	
2.6	Koeficienti i vrazhdësisë për llogaritjen hidraulike	k = 0.5 mm	
2.7	Saracineska izolimi	Siç kërkohet për izolimin e seksioneve të rrjetit gjatë riparimit dhe emergjencave	
2.8	Matesia uji me kasete/kuti	Kuti / puseta të vetme dhe të shumëfishta të ujëmatësve në varësi të distancës së shtëpive ose grupeve të shtëpive; të vendosura në tokë publike sipas praktikës së përgjithshme në Shqipëri:	

		Kuti të parafabrika të ujëmatësve individual dhe të shumëfishtë	
2.9	Hidrantet	Hidrantet do të vendosen përgjat tubacioneve me diametër DN90 ose me të mëdhenje (në një distancë prej 200m) përfshirë shkollat dhe institucionet Në pikat e ulëta të rrjetit të shpërndarjes janë parashikuar hidrantë shtesë për shpëlarje.	
2.10	Mates uji	Mates uji, multi-jet, dry dial, MID I aprovuar, R 80, PN 16, DN 15, Q3 = 2.5 m ³ /h	
3	Depo Uji		
3.1	Depo	Duke pasur parasysh se kërkesa specifike mesatare për projektimin e sistemit të furnizimit me ujë varion ndërmjet 150 - 200 l/b/d, konsiderohet se vëllimi i depozitimit të rezervuarit përfshin një rezervë për shuarjen e zjarrit.	

15.3 Informacionin për infrastrukturën e nevojshme

(dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

15.3.1 Rrjeti Elektrik, Sistemi i Ndrçimit dhe IT

Rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe transmetimin e të dhënave është i përbërë nga dy sisteme:

- Sistemi elektrik i fuqisë, i cili është i përbërë nga rrjeti 1-fazor me tension 230 V dhe frekuencë 50 Hz.
- Sistemi i teknologjisë së informacionit (IT), i cili konsiston në marrjen dhe shfaqjen e informacionit në formë elektronike dhe imazherike.

Furnizimi me energji elektrike do të realizohet nëpërmjet rrjetit 1-fazor me tension 230 V dhe frekuencë 50 Hz. Linja elektrike furnizuese do të shërbejë si hyrje në kuadrin elektrik, i cili është me mbrojtje mekanike, hidrike dhe grimcave të pluhurit me IP të treguar në fletët e vizatimit përkatës. Kuadri elektrik do të përmbajë mbrotjen magneto-termike kryesore dhe diferenciale; gjithashtu, secila linjë kryesore sistemi është mbrottur me mbrotje magneto-termike.

Topologjia e qarkut elektrik do të jetë në formë kaskadë: Linjë kryesore furnizimi elektrike - kuadër elektrik – kutia shpërndarëse elektrike – prizë ose çelës elektrik dhe ngrakesë.

Ngjyrat e kabllove që do të përdoren gjatë instalimeve elektrike janë:

- ngjyra blu – përcellësi i neutrit;
- ngjyra verdhë-jeshil – përcjellësi i tokëzimit
- ngjyrat e tjera përveç ngjyrave të lartpërmendura do të përdoren për përcjellësin e fazës.

Sistemi elektrik i fuqisë ka disa nënsisteme, të tilla si: sistemi i furnizimit të prizave të fuqisë dhe sistemi i ndriçimit. Për nevojën gjatë vendosjes së tubacioneve dhe rakorderive është parashikuar të vendosen dy

priza fuqie 1-fazore 16 A , 230 V (një prizë në katin -1 dhe një prizë në katin 0), siç tregohen në vizatimet përkatëse. Kabllot do të jenë me përcjellës prej bakri 3x1.5 mm² dhe të veshur me PVC. Lartësia e vendosjes së prizave ngas dyshemeja është minimumi 40 cm dhe instalim jashtë murit. Për mbrojtjen mekanike dhe termike, kabllot do të futen në tuba plastik të fortë (rigid) me dismensione siç tregohen në vizatimet përkatëse. Pompa do të ketë linjën e dedikuar të furnizimit me energji elektrike, me kabëll 3x1.5 mm² dhe të futur në tub plastik të fortë D20mm. Priza e katit të -1 do të mbrohet me automatën që mbron linjën e ndriçimit dhe priza e katit 0 do të mbrohet me automatën e që mbron linjën e pompës.

Sistemi i ndriçimit është i përbërë prej 6 ndriçuesve të brendshëm për instalim tavanor (tre ndriçues në katin -1 dhe tre ndriçues në katin), fuqia noniminale e tyre është 45 W, IP 65, fluksi i dritës duhet të jetë jo më i vogël se 5000 lumen) dhe shpërndarje të dritës siç tregohet në figurën e mëposhtme. Gjithashtu, në mjediset e jashtme duhet të vendosen dy ndriçues në formë prozhektori me fuqi 50 W dhe fluksi i dritës jo më të ulët se 5000 lumen) dhe IP 67.

Properties	\bar{E} (Target)	E_{min}	E_{max}	$U_0 (g_1)$ (Target)	g_2	Index
Working plane (Dhoma hyrjes) Perpendicular illuminance (adaptive) Height: 0.800 m, Wall zone: 0.500 m	432 lx (≥ 200 lx) ✓	227 lx	709 lx	0.53 (≥ 0.40) ✓	0.32	WP2

Figura 1-15: Parametrat kryesor të ndriçimit (shkalla e ndriçimit E dhe uniformiteti U_0)

Tre ndriçuesit e katit -1 do të komandohen me çelësi përkatës, po ashtu edhe kati 0, edhe ndriçuesit e jashtëm do të kënë çelësin elektrik 10 A. Vendosja e tyre do të jetë siç tregohet në vizatim, 20 cm distancë nga fashatura e derës me lartësi 120 cm.

Linja elektrike që lidh kuadrin elektrik me kurinë shpërndarëse do të jëtë e instaluar nën tokë në tub të fortë D32 mm dhe të mbrotur nga presionet mekanike të ushtruara nga lart, seksioni tërthor i kabullit do të jetë 3x4 mm².

Sistemi i IT do të shëmbëjë për mbikqyrjen e objejtit për të parandaluar dhe mbrojtur objektin kundrejt vjedhjeve dhe sulmeve të ndryshme. Për këtë arsye janë parashikuar të instalohen katër kamera rrjeti me rreze shikimi minimumi 30 m. Do të montohen shtyllë metalike në lartësi minimale 4 m, shtylla do të tokëzohet nëpërmjet një elektrode tokëzimi pranë shtyllës. Secila kamerë do të lidhet në rregjistruesin NVR të vendosur brenda kasetës metalike me IP 67 pranë kuadrin elektrike. Një memorei e jashtëm do të përdoret për të rregjistruar videot me ngarkesë deri në 6 TB. Linjat e IT do të futen në tuba plastik të fortë me diametër 20 mm. Furnizimi i sistemit të IT do të realizohet nëpërmjet një UPS të instaluar në kasetën e IT; parametrat e UPS janë: tensioni në hyrje 170 -270 V, tensioni në dalje 230 V, frekuencë 50 Hz, dhe autonomi 15 minuta. Për të realizuar mbikqyrjen në kohë reale nëpërmjet kamerave, do të merret linjë interneti, e cila do të lidhet me NVR nëpërmjet një routeri të instaluar në kasetën metalike të IT.

Sistemi i tokëzimit do të përbëhet nga 3 elektroda tokëzimi me gjatësi 1.5 m të futura në tokë, kreu i elektrodës së tokëzimit do të jetë 0.5 m nën tokë, elektrodën e tokëzimit do të lidhen nëpërmjet përcjellësve të zhveshur prej bakri dhe do të lidhen te kuadri elektrik ku është montuar mbrojtja diferenciale.

15.3.2 Sistemi i furnizimit me ujë (FUP)

Kjo zone ka një rrjet shpërndarës të degraduar dhe shumë të amortizuar, ndërtim i vitit 1980. Banorët e kësaj zone vuajnë prej vitesh mungesën e një rrjeti për furnizimin me ujë 24 orë. Sic u përmend dhe për linjat e dërgimit, edhe në linjat e rrjetit shpërndarës ekziston problemi i tubacioneve të cilat janë trasuar mbi

sipërfaqen e tokës dhe në këtë rast vihet re një problematike shtese, që është shtrirja e këtyre linjave mbi prona private, gjë që e bën mjaft të ndërlikuar procesin e mirëmbajtjes së rrjetit si dhe sjell problemet që lidhen me ndërhyrjet dhe lidhjet e paligjshme.



Figura 15-7: Pamje nga burimi VM 4

Ky byrim duhet të mbrohet dhe të behet i përdorshëm nga banoret.

15.3.3 Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN)

Sistemi i shkarkimeve të ujërave të ndotura ekzistues nuk vërehet në gjurmët e këtij projekti.

15.3.4 Sistemi i largimit të ujërave të shiut (KUSH)

Në zonën në studim sidomos në pjesën kodrinore rrjeti hidrografik është shumë pak i dukshëm.

Me përjashtim të disa prroskave, apo të një përroi të vogël që rrjedh gjatë shirave në Grabian nuk ka rrjedhje të tjera.

Nga ana hidrografike kemi edhe disa rezervuar, të cilët ndodhen në veri të Gradishtit dhe jug të Grabianit rreth 1 km dhe përfaqësohet nga rezervuari i Përroit të Plemes me një sipërfaqe rreth 1500-2000 m². Rezervuari i cili ndodhet në perëndim të fshatit, në krye të tij i cili ka një sipërfaqe të vogël, si dhe rezervuari i cili ndodhet në veri-perëndim të fshatit Grabjan. Këto rezervuar ujëmbledhës shërbejnë për vaditjen e tokave të zonës.

Largimit të ujërave të shirave në zonën fushore realizohet me anë të kanaleve të cilat shtrihen në pjesën më të madhe të projektit.

15.4 Programin për ndërtimin, "Grafiku i punimeve"

(e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;

- programin për ndërtimin, referohu materialit bashkëngjitur raportit për Grafikon e punimeve;
- kohëzgjatjen e ndërtimit, 18 muaj
- kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, për 25 vite
- kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit është proces që zgjat me vite;
- fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit është projekt rehabilitimi sipërfaqeje dhe është i projektuar për një periudhë 25 vjeçare

Nr.	Pershkrimi i Punimeve	PERIUDHA E NDËRTIMIT (18 MUJ)J																								
		Muaj 1	Muaj 2	Muaj 3	Muaj 4	Muaj 5	Muaj 6	Muaj 7	Muaj 8	Muaj 9	Muaj 10	Muaj 11	Muaj 12	Muaj 13	Muaj 14	Muaj 15	Muaj 16	Muaj 17	Muaj 18							
1	Ngritja karrieri	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	
2	Punime për ndërtimin e depocit me re 1500m ³ dhe ndërtesës së klorit në Gradishtë. Punime mekanike në Depo																									
3	Punime për linjen e dergimit nga pusi I ri - Depo e re 1500m ³ Gradishtë.																									
4	Punime për Pajet e lidhjes në Depon ekzistuese Graban.Linja e dergimit nga depo ekzistuese-Depo e re 1500m ³																									
5	Happa e pusit të ri G-05 në Gradishtë dhe Rehabilitimi i pusit ekzistues.																									
6	Punime për rrytin shpërndarës Gradishtë																									
7	Punime për rrytin shpërndarës Spolat																									
8	Punime për rrytin shpërndarës Mërtish																									
9	Punime për rrytin shpërndarës Këmishtaj																									
10	Punime për rrytin shpërndarës Ferras																									
11	Punime për rrytin shpërndarës Sopez																									
12	Punime për rrytin shpërndarës Gungas																									
13	Punime për rrytin shpërndarës Babunjë																									
14	Punime për rrytin shpërndarës Senesa																									
15	Punime për rrytin shpërndarës Gorica																									
16	Punime për rrytin shpërndarës Fier Seman																									
17	Testimi i presionit të tubacioneve																									
18	Rikthimi i rrugëve në gendje fillestare																									
19	Dorëzimi i punimeve																									

Figura 15-8: Grafiku i punimeve

15.5 Materiale ndërtimi

(ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth / pranë zonës së projektit;

Nisur nga fakti se projekti i kategorizuar si rrugë, atëherë dhe zërat kryesorë të lëndëve të para, që do të përdoren janë:

- Materiale të dala nga gërmimet (dhera, zhavorre, inerte dhe mbetje materialesh ndërtimi);
- Asfalto beton
- Beton
- Materiale plastike (siç janë, pusetat, tubacionet, apo elemente të tjerë plotësues)

Ky projekt ka një shtrirje të madhe dhe punimet do të kryhen në gjithë gjatësinë e saj, ku shërbimi i ujit dhe lidhja me energji do të sigurohet nga nënkontraktori në bashkëpunim me zhvilluesin.

15.6 Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera

(f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

Raste që ky projekt lidhet me projektet e tjera janë;

Projekti do të lidhet edhe me projektet e tjera të cilat janë në proces ndërtimi ose projektim në zonën në të cilën ndodhet projekti

15.7 Informacionin për alternativat e marra në konsideratë

(g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

Sistemi i furnizimit me ujë përbëhet nga Depo për akumulimin e ujit, sistem dërgimi nga depo ekzistuese e Grabianit (1'000 m³) në kuotën 138 m mbi nivelin e detit do të furnizojë Depon e Re në Gradisht (1500 m³) me anë të një tubi DN315, PN16 me një prurje llogaritëse 30 l/s. Linja e dërgimit do të ketë gjithashtu valvula kontrolli, valvula shkarkimi dhe ajrimi.

Sistemi i Dërgimit nga Pusi i Ri (Gradishtë) (kuota 11 m m.n.d) do të ndërtohet një linjë dërgimi DN 125 PN 16 me gjatësi 1230 m e cila nëpërmjet ngritjes mekanike (Pompë m prurje llogaritëse 5 l/s dhe rënie bruto 140 m) do të marrë dhe dërgojë një prurje prej 5 l/s në Depon e Re në Fshatin Gradishtë.

Nga Depo e Re në Gradisht do të Dalin tre linja kryesore furnizimi, Linja LF1 e cila shkon në drejtim të veriut dhe shërben për të furnizuar pjesërisht fshatin Gradisht dhe Fshatin Spolat. Linja LF2 e cila shkon drejt perëndimit dhe shërben për të furnizuar fshatrat Gradisht, Fier-Seman, Gungas dhe Babunjë. Ndërsa linja LF3 e cila shkon drejt lindjes shërben për të furnizuar fshatrat Gradisht, Mërtish, Ferras, Senesa, Kemishtaj, Gorica dhe Sopez. Linjat e furnizimit do të kenë valvula kontrolli, shkarkimi dhe vetëm Linja LF1 do të ketë 1 valvul ajrimi.




Figura 15-9: Horografia

15.8 Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para

(gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

Nuk ka përdorim lëndësh gjatë shfrytëzimit.

15.9 Aktivitete të tjera që mund të nevojiten

(h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave, etj.;

Për ndërtimin e projektit nuk do jetë e nevojshme kryerja e aktiviteteve shtesë, si ndërtim i kampeve apo rezidencave. Punonjësit që do të punësohen do të jenë lokalë dhe stafi inxhinierik do të sistemohet në shtëpitë e tyre të banimit.

15.10 Informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat për projektin

(i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin / licencimin e projektit;

Bashkëngjitur këtij raporti janë të gjitha lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme të projektimit, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin / licencimin e projektit;

15.11 Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi

(j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin / licencimin e projektit;

Në proces nga zhvilluesi.

16 KORESPONDENCA

Pas vizitës në terren Konsulenti u qartësua me problematikat e zonës së projektit dhe tashmë është i gatshëm të parashtroj zgjidhjet e këtyre problematikave sipas legjislacionit dhe normave në fuqi. Për nevoja të këtij projekti që lidhen kryesisht me informacion më të detajuar të gjurmës së projektit për avancimin e zgjidhjes në projektim, konsulenti ka përgatitur disa kërkesa drejtuar institucioneve të cilat ofrojnë shërbim në këtë zonë ose janë pronarë të objekteve nën gjurmën e rrugëve apo kanaleve që do të zhvillohen. Më poshtë paraqitet lista e Institucioneve të cilave u janë drejtuar kërkesat.

Tabela 16-1: Lista e kërkesave për institucionet

NR RENDOR	LËNDA	EMRI I MARRËSIT	DATA E SHKRESËS	NR I PROTOKOLLIT TË SHKRESËS
11.775	Kërkesë për informacionin e disponueshëm (harta) në lidhje me hidrocentralet dhe minierat e pranishme (nëse ka të tilla) duke patur parasysh gjurmën e këtij projekti.	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)	23.02.2024	350-1D
11.776	Kërkesë për vinen në dispozicion PPV dhe PDV e zonës që preket nga projekti.	Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit	23.02.2024	350-2D
11.777	Kërkesë për informimin mbi gjendjen aktuale, si dhe të na vini në dispozicion planet ose projektet e miratuara si dhe ato në zhvillim të institucionit tuaj për zonën në studim, më specifikisht: sistemin e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizimit me ujë të ndërtesave dhe linjave tranzit që kalojnë në këtë zonë si dhe mbetjeve të ngurta urbane.	Agjencia Kombëtare Ujësjetellës Kanalizimeve (AKUK)	23.02.2024	350-3D
11.778	Kërkesë për informimin mbi zonat e mbrojtura nën administrimin tuaj (nëse ka), në gjurmën e këtij projekti.	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)	23.02.2024	350-4D
11.779	Kërkesë për dërgimin e informacionit të disponueshëm mbi burimet natyrore duke patur parasysh gjurmën e këtij projekti	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Natyrore (AMBU)	23.02.2024	350-5D
11.780	Kërkesë për informimin mbi zonat e Trashëgimisë Kulturore të mundshme (nëse ka), në gjurmën e këtij projekti.	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA)	29.12.2023	350-6D
11.781	Kërkesë vënie në dispozicion planet ose projektet e miratuara si dhe ato në zhvillim të institucionit tuaj, si edhe rrjetet përkatëse inxhinierike, publike ose private nën administrimin tuaj, në gjurmën e këtij projekti.	Bashkia Lushnje	23.02.2024	350-7D
11.782	Kërkesë dhenie informacioni mbi listën e monumenteve të kulturës (nëse ka), në gjurmën e këtij projekti	Instituti të Monumenteve të Kulturës	23.02.2024	350-8D
11.783	Kërkesë për vinen në dispozicion planet ose projektet e miratuara si dhe ato në zhvillim të institucionit tuaj për zonën në studim, si edhe rrjetet përkatëse inxhinierike të TM-së dhe TU-së, publike ose private nën administrimin tuaj, në gjurmën e këtij projekti.	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.	29.12.2023	350-9D

NR RENDOR	LËNDA	EMRI I MARRËSIT	DATA E SHKRESËS	NR I PROTOKOLLIT TË SHKRESËS
11.784	Kërkesë për veniennë dispozicion planet ose projektet e miratuara si dhe ato në zhvillim të institucionit tuaj për zonën në studim, si edhe rrjetet përkatëse inxhinierike, publike ose private nën administrimin tuaj, në gjurmën e këtij projekti, konkretisht	Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A	23.02.2024	350-10D
11.785	Kërkesë për informacion mbi planet ose projektet e miratuara dhe në zhvillim të institucionit tuaj mbi zhvillimin e turizmit në gjurmën e këtij projekti.	Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit	23.02.2024	350-11D

Nga kërkesat e dërguara është kthyer përgjigje nga institucionet e mëposhtme:

Tabela 16-2: Lista e kthim përgjigjeve në pritje

NR.	EMRI I MARRËSIT	DATA E SHKRESËS	KTHIM PËRGJIGJE
1	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Natyrore (AMBU)	23.02.2024	26.02.2024
2	Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit	23.02.2024	29.02.2024
3	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)	23.02.2024	05.03.2024
4	Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit	23.02.2024	11.03.2024
5	Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A	23.02.2024	12.03.2024

17 KRITERET E PROJEKTIMIT

17.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike

Projektimi i këtij ujësjellësi është realizuar në përputhje me :

- Detyra e Projektimit, nga Porositësi
- Rregulloren Teknike RT 2018 për Projektimin dhe Ndërtimin e Sistemit të Ujësjellës Kanalizimeve, Pjesa I dhe II
- Standardi Evropian BS EN 805
- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor.
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet në struktura.
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave të betonit.
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku.
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik.
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave për rezistencë nga tërmeti
- IEC 60364 series: Low-voltage electrical installations - Selection and erection of electrical equipment
- Devices for protection for safety, isolation, switching, control and monitoring

REFERENCAT

- Detyra e Projektimit, nga Autoriteti kontraktues
- VKM Nr. 628, date 15.07.2015 Për miratimin e Rregullave të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve
- Rregulloren Teknike RT 2018 për Projektimin dhe Ndërtimin e Sistemit të Ujësjellës Kanalizimeve, Pjesa I dhe II
- ICE-349-P01-V01 Raporti gjeologo - inxhinierik.
- ICE-349-P01-V01 Raporti Hidrogjeologjisë
- ICE-349-P01-V01 Raporti Teknik i Projekt Zbatimit

